



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

UDHËZIM

PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN E VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË
KANDIDIMIT, AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTAVE TË KANDIDATËVE DHE MIRATIMIN E MODELEVE
TË KANDIDIMIT PËR ZGJEDHJET E QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, 64, pika 2, shkronja “e”, 67, 68, 70, 71, 72, 73, dhe 92/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të vendimit të Kuvendit, nr.17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”

U D H Ë Z O J:

Neni 1

Modelet e kandidimit

1. Subjektet zgjedhore, për zgjedhjet e qeverisjes vendore, duhet të paraqesin në KQZ/KZAZ, dokumentacionin e kandidimit të shoqëruara me modelet e kandidimit si vijon:
 - a) Formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (jo më vonë se 100 ditë përpara datës së zgjedhjeve) Model KQZ-04-01;
 - b) Deklarata e angazhimit solemn e kryetarit të partisë politike (jo më vonë se 70 ditë përpara zgjedhjeve) Model KQZ-04-02;
 - c) Deklaratë për hapje llogarie të posaçme bankare të partisë politike (jo më vonë se 70 ditë përpara zgjedhjeve) Model KQZ-04-03;
 - d) Kërkesë për regjistrimin e Komitetit Nismëtar (jo më vonë se 70 ditë përpara zgjedhjeve) Model KQZ-04-04;
 - e) Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit (jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve Model KQZ-04-05;



- f) Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie propozuar nga parti politike/koalicion (jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve) Model KQZ-04-06;
 - g) Kërkesë për regjistrimin e listës shumemërore për anëtarë të këshillit bashkiak propozuar nga parti politike/koalicion (jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve) Model KQZ-04-07;
 - h) Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme (jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve) Model KQZ-04-08;
 - i) Deklaratë për pranimin e kandidimit (jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve) Model KQZ-04-09;
 - j) Procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit (jo më vonë se 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve) Model KQZ-00-31.
2. Modelet e kandidimit shoqërohen me pjesën sqaruese ku përcaktohet mënyra e plotësimit të tyre.
 3. Modelet e kandidimit pasqyrohen në shtojcën që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Neni 2

Dokumentet e kandidimit

1. Subjektet zgjedhore, për zgjedhjet e qeverisjes vendore, duhet të paraqesin në KQZ/KZAZ, jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesën për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie si dhe listën e kandidatëve për këshillin e bashkisë me renditjen përkatëse të nënshkruar nga kryetari i partisë, kryetari i partisë udhëheqëse të koalicionit, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 Propozimin nga komiteti nismëtar për të regjistruar kandidatin për kryetar bashkie ose anëtar të këshillit bashkiak, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 Kandidatët, nëse planifikojnë të pranojnë dhurime për fushatën e tyre, hapin llogari bankare të posaçme për të pranuar dhurimin e fondeve jopublike, sipas pikës 3, të nenit 92/2, të Kodit Zgjedhor dhe e deklarojnë në momentin e regjistrimit të listës së kandidatëve/kandidatit, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 - b) Kopjen e dokumentit të identifikimit të çdo kandidati në listë;
 - c) Deklaratën e kandidatit ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” e “ç”, të nenit 72, të Kodit Zgjedhor sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - ç) Sipas rastit, kopjen e deklaratës së dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 63, të Kodit Zgjedhor depozituar dhe protokolluar pranë institucionit përkatës;
 - d) Vërtetimin e nënshkruar nga Kuvendi ose njësia përkatëse e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose organit të njësisë së qeverisjes vendore;

dh) Formularin tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin, në përputhje me nenet 68, 70 dhe 71, të Kodit Zgjedhor sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Formularit tip i bashkëlidhet fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga çdo zgjedhës.

2. Bashkë me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, subjektet zgjedhore depozitojnë formularin e vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 5, të këtij udhëzimi.
3. Në momentin e depozitimit të dokumenteve të kandidimit duhet depozituar edhe procesverbali i dorëzimit të dokumenteve, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi.
4. Në çdo rast, deklaratat me elementet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, do të plotësohen sipas të dhënave në dokumentin e identifikimit të kandidatit.

Neni 3

Dorëzimi i dokumentacionit të kandidimit

1. Dokumentacioni i kandidimit për kandidatin për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe për kandidatët për këshillat vendore depozitohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në nenin 67 pika 1 e Kodit Zgjedhor. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.
2. Për bashkitë Shkodër; Lezhë; Durrës; Kamëz; Tiranë; Elbasan; Lushnjë; Fier; Berat; Korçë; Vlorë dokumentacioni i kandidimit dhe formulari i vetëdeklarimit depozitohet në KQZ. Për të gjitha bashkitë e tjera të cilat mbulohen nga një KZAZ e vetme, dokumentacioni i kandidimit e depozitohet në KZAZ-në përkatëse.

Neni 4

Verifikimi i dokumentacionit të kandidimit

1. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së kryen verifikimin e dokumentacionit të kandidimit në lidhje me përputhshmërinë e tij me kërkesat e neneve 67, 68 dhe 72, të Kodit Zgjedhor, të duke ndjekur këtë radhë veprimi:
 - a) Verifikon nëse subjekti parti politike/koalicion është regjistruar si subjekt zgjedhor
 - b) Verifikon nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar;
 - c) Verifikon plotësimin e kushteve/kritereve të përcaktuara në dispozitat e neneve 67 deri 72, të Kodit Zgjedhor, përfshirë edhe zbatimin e kuotës gjinore;
 - d) Verifikon plotësinë e dokumenteve të kandidimit dhe të nënshkrimeve;
 - ç) Në rast se konstatohet mosplotësimi i kushteve/kritereve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, apo mungojnë dokumente, administrata i kërkon menjëherë subjektit zgjedhor të bëjë plotësimin e dokumenteve.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja miraton ose refuzon listën e kandidatëve për zgjedhjet e qeverisjes vendore.



Neni 5

Dorëzimi i formularit të vetëdeklarimit

1. Formularët e vetdeklarimit për kandidatët për zgjedhjet e organëve të qeverisjes vendore, të propozuar nga partitë politike/koalicioni/komiteti nismëtar depozitohen në KQZ/KZAZ, sipas rastit, krahas dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, sipas modelit të miratuar në pikën 5, të kreut III, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”.
2. Në rastet kur depozitimi i dokumentacionit të kandidimit dhe formularëve të vetëdeklarimit bëhet në KZAZ, lista përfundimtare e kandidatëve, së bashku me formularët e vetdeklarimit për secilin kandidat përcillen menjëherë por jo më vonë se 24 orë nga dorëzimi, në KQZ.

Neni 6

Verifikimi i formularit të vetëdeklarimit

1. Administrata e KQZ-së verifikon prima facie të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016.
2. Administrata e KQZ-së, si rregull, brenda 72 orëve nga dorëzimi i formularëve të vetëdeklarimit, evidenton rastet e refuzimit apo të mosparaqitjes së formularit të vetëdeklarimit. Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për refuzimin e regjistrimit të kandidatit në zgjedhje nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
3. Në varësi të rezultatit të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit, administrata i paraqet për miratim Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, projektaktin përkatës, sipas përcaktimeve në nenin 10, të ligjit nr.138/2015.
4. Vendimi për refuzimin e regjistrimit të kandidatit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i njoftohet, menjëherë, subjektit zgjedhor, ose kandidatit të propozuar nga zgjedhësit. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore vendimi për refuzimin e regjistrimit të kandidatit apo vendimi për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatëve i njoftohet menjëherë KZAZ-së që mbulon njësinë e qeverisjes vendore.
5. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për refuzimin e regjistrimit përmban dhe sqarimin për të drejtën e subjektit për zëvendësimin e kandidaturës, jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 7

Verifikimi i nënshkrimeve



1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja cakton një seancë publike për verifikimin e nënshkrimeve në të cilën marrin pjesë përfaqësuesit e subjektit zgjedhor ose komitetit nismëtar, dhe/ose përfaqësuesit e subjekteve të tjera zgjedhore.
2. Në datën dhe orën e përcaktuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/ KZAZ-ja për zhvillimin e seancës, administrata e KQZ-së/KZAZ-së disponon një kopje të formularit tip të plotësuar nga nënshkrimet mbështetëse.
3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së përzgjedh në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve që mbështesin subjektin zgjedhor përkatës të kopjes së formularit tip të nënshkrimeve.
4. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së verifikon nënshkrimin e kandidatëve duke përcaktuar nëse nënshkruesit janë zgjedhës me vendbanim në zonat zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit.
5. Numri i nënshkrimeve të rregullta pjesëtohet me numrin që përfaqëson 5% të të gjitha nënshkrimeve të paraqitura. Numri që del nga ky pjesëtim shumëzohet me numrin e nënshkrimeve të paraqitura. Rezultati që del nga këto veprime përfaqëson numrin e nënshkrimeve të rregullta në listën e paraqitur.
6. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve të rregullta është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor.

Neni 8

Kthimi për plotësim dhe miratimi i dokumentacionit zgjedhor

1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe, nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së zgjedhjeve.
2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 (dyzet e dy) ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.
3. Administrata e KQZ-së/KZAZ-së, si rregull, jo më vonë se 24 orë nga ridepozitimi, verifikon dokumentacionin e plotësuar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve/KZAZ-ja vendos për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit të kandidimit, jo më vonë se 24 orë.

Neni 9

Vendosja e sanksioneve

Mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit, për zgjedhjet për këshillat bashkiakë , një në cdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditjen e listës shumëmemërore të kandidatëve duhet ti përkasë së njëjtës gjini, passjell refuzimin e regjistrimit të listës.

Neni 10

Afatet për publikimin e listës së kandidatëve

1. Pas mbarimit të afatit të ankimimeve në Kolegjin Zgjedhor, KQZ-ja publikon listën e plotë të kandidatëve në media elektronike e sociale, si dhe në faqen e saj zyrtare në internet.
2. Një kopje e listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet Prefektit, Këshillit të Qarkut dhe KZAZ-ve. Prefekti dhe Këshilli i Qarkut e publikojnë listën e kandidatëve të zonës zgjedhore e në mediat vendore që kanë mbulimin më të gjerë me sinjal në qark si dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre. KZAZ-të përkatëse, menjëherë pas marrjes së listës shumemërore nga KQZ-ja, i afishojnë në hyrjen e selisë së tyre.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Udhëzimi nr.1, datë 23.12. 2020, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve” shfuqizohet.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATA E ANGAZHIMIT SOLEMN E KRYETARIT TË PARTISË POLITIKE

Zgjedhje për Organet e Qeverisjes Vendore

Data e zgjedhjeve

I) TË DHËNAT E
KRYETARIT

Partia (emri zyrtar i partisë)

(shkronjat nistore)

(Adresa e partisë)

Kryetari i partisë z/znj

(emër, atësi, mbiemër i kryetarit të partisë)

DEKLAROJ NË CILËSINË E KRYETARIT TË PARTISË:

Angazhimin solemn të Partisë tonë se, pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë/ ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikën e blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale.

Angazhohemi të zbatojmë rregulla për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tanë që: Të mos premtojnë/ ofrojnë/ japin para, mallra, shërbime dhe/ose nxisin premtime për punësim apo trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe/ose të tjerëve, duke përfshirë familjet e votuesve apo komuniteteve të ndryshme apo të veprojnë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë, ose arsyeshëm pritët të ndikojë në mënyrën se si votuesit japin votën e tyre;

- Të zbatojmë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane për votim universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejtë;
- Të respektojmë të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, organizatave, partive politike, për të promovuar dhe debatuar çështje politike;
- Të mos përfshihemi në praktika kërcënuese ose pengimi për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.
- Të bëjmë publike në kohë reale pranë KQZ-së dhe faqen zyrtare të subjektit tonë politik çfarëdolloj donacioni si dhe të refuzojmë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që:

- Tejkalojnë limitin e përcaktuar për donacion;
- Janë kontribute në para apo në natyrë me prejardhje nga burime të ndaluara që përfshijnë edhe të ardhurat nga krimi, individë, kompani të huaja nga vende me origjinë të dyshimtë/të parajsave fiskale;
- Janë donacione të cilat nënkuptojnë apo perceptohen si favorizime për dhënie kontrata publike, emërimë në funksione publike apo përfitime të tjera që shkojnë në emër e për llogari të dhuruesit.

Kryetari i Partisë

(emër, atësi, mbiemër i kryetarit të partisë)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

“DEKLARATË SOLEMNE E KRYETARIT TË PARTISË POLITIKE”

1. Ky dokument plotësohet dhe nënshkruhet nga kryetari i partisë politike.
2. Në **Seksionin (I)** kryetari i partisë politike plotëson të dhënat identifikuese të tij si dhe të dhënat e partisë politike që përfaqëson.
3. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
4. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëhere, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse.**
5. Kryetari i Partisë politike duhet të nënshkruajë në fund të këtij dokumenti.
6. *Deklarata Solemne e kryetarit të partisë politike, gjen mbështetje në nenin 64, pika 2, shkronja “e”, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.*





MODEL-02

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË
PËR HAPJE LLOGARIE TË POSAÇME BANKARE TË PARTISË POLITIKE

Zgjedhje për Organet e Qeverisjes Vendore

Data e zgjedhjeve _____

Partia _____ , _____
(emri zyrtar i partisë) (shkronjat nistore)

I) TË DHNAT
E LLOGARISË

Numri i llogarisë

Banka

II) HAPUR
NGA

Kryetari i Partisë

Person i autorizuar nga Kryetari

(Emër Mbiemër)

AUTORIZOJ

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e tij për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

Kryetari i Partisë/Personi i autorizuar prej Kryetarit

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

DEKLARATË

PËR HAPJE LLOGARIE TË POSAÇME BANKARE TË PARTISË POLITIKE

1. Ky dokument plotësohet dhe nënshkruhet nga Kryetari i Partisë Politike ose personi i autorizuar prej tij.
2. Në **Seksionin (I)** deklaruesi plotëson të dhënat e partisë politike sipas fushës përkatëse.
3. Në **Seksionin (II)** dhe **Seksionin (III)** deklaruesi plotëson të dhënat e llogarisë bankare ose të dhënat e personit që ka hapur llogarinë bankare.
4. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
5. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëhere, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse.**
6. Deklaruesi duhet të nënshkruajë në fund të këtij dokumenti.
7. *Deklarata për hapje llogarie të posacme të partisë politike gjen mbështetje në nenin 92/2 pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË E KANDIDATIT PËR HAPJE LLOGARIE BANKARE TË POSAÇME

Zgjedhje për Organet e Qeverisjes Vendore

Data e zgjedhjeve _____

I) TË DHËNAT E
KANDIDATIT

1. _____ 2. Datëlindja _____
(Emër, Atësia, Mbiemër) dd/mm/vvvv
3. Adresa _____
4. Gjinia M F 5. Vendlindja _____
Bashkia Qarku

II) PROPOZUESI

a) Parti _____ , _____
(emri zyrtar i partisë) (shkronjat nistore)
b) Koalicion _____ , _____
(emri zyrtar i koalicionit) (shkronjat nistore)
c) I propozuar nga zgjedhësit

III) TË DHËNAT
E LLOGARISË

Numri i llogarisë

Banka

AUTORIZOJ

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e tij për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

KANDIDATI

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

"DEKLARATË E KANDIDATIT PËR HAPJE LLOGARIE BANKARE TË POSAÇME"

1. Ky dokument plotësohet nga Kandidati i propozuar nga partia politike/koalicioni/kandidati i propozuar nga zgjedhësit.
2. Në **Seksionin (I)** kandidati plotëson të dhënat identifikuese të tij, sipas fushave përkatëse.
3. Në **Seksionin (II)** kandidati shënon me kryq kuadratin përbri subjektit mbështetës më pas plotëson të dhënat e subjektit të përzgjedhur.
4. Në **Seksionin (III)** kandidati plotëson të dhënat e llogarisë bankare, sipas fushave përkatëse.
5. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
6. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëherë, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse.**
7. Kandidati duhet të nënshkruajë në fund të këtij dokumenti.
8. *Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme të kandidati gjen mbështetje në nenin 92/2 pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR BASHKIE

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

I) SUBJEKTI
KËRKUES

Partia/Koalicioni

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

(shkronjat nistore)

II) ZONA

Qarku

Bashkia

III) DREJTUAR

KQZ

KZAZ nr.

IV) TË DHËNAT E
KANDIDATIT

1. _____
(Emër) (Mbiemër) (Atësia) (Mëmësia)

2. Datëlindja _____ 3. Adresa _____
dd/mm/vvvv

4. Gjinia M F 5. Vendlindja _____
Bashkia Qarku

5. Arsimi i mesëm i lartë 6. Punësimi Aktual _____

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Vula

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

“KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR BASHKIE”

1. Ky dokument plotësohet nga kryetari i partisë politike/përfaqësues i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre.
2. Në **Seksionin (I)** kërkuesi plotëson të dhënat e partisë politike sipas fushave përkatëse.
3. Në **Seksionin (II) dhe (III)** kërkuesi plotëson Qarkun dhe Bashkinë ku kandidon kandidati për Kryetar Bashkie, si dhe kujt i drejtohet kërkesa e kandidimit KQZ/KZAZ-së dhe sipas rastit plotëson nr e KZAZ-së.
4. Në Seksionin **(IV)** kërkuesi plotëson të dhënat identifikuese të kandidatit sipas fushave përkatëse.
5. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
7. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëherë, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse**.
8. Kryetari i partisë/koalicionit ose personi i autorizuar prej tij duhet të nënshkruajë në fund të këtij dokumenti.
9. Këtij dokumenti duhet t'i bashkëlidhet:
 - a) Deklarata e nënshkruar nga kandidati që gëzon të drejtën dhe ka dëshirë të kandidojë, sipas rastit deklarimin e dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në nenin 63 të Kodit Zgjedhor
 - b) Formulari i Vetëdeklarimit pasi të nënshkruhet nga kandidati duhet të depozitohet pranë KQZ/KZAZ
 - c) Vërtetim për zotërimin e mandatit sipas nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, listën e zgjedhësve që mbështesin partinë/koalicionin.
 - ç) Autorizimi i Kryetarit të Partisë për nënshkrimin e dokumentit të kandidatit për Kryetar Bashkie. (nëse dokumenti nuk është nënshkruar nga kryetari i partisë sipas nenit 72, pika 3 e Kodit Zgjedhor).
 - d) Deklarata e kandidatit për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike.
10. Kërkesa për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie gjen mbështetje në nenin 67, dhe nenit 72, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

MODEL-03/1

KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

I) TË DHËNAT
E SUBJEKTIT

Partia/Koalicioni

(emri zyrtar i partisë/koalicionit), (shkronjat nistore)

II) ZONA E
KANDIDIMIT

QARKU
BASHKIA

III)
DREJTUAR

KQZ
KZAZ nr.

IV) TË DHËNA KANDIDATI

LISTA SHUMEMËRORE E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK

Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti tËPËRQË Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
1												
2												
3												
4												
5												
6												
7												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre

(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Vula

VAZHDIM I LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK

MODEL - 03/1

Partia/Koalicioni

QARKU

BASHKIA

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

IV) TË DHËNA KANDIDATI

Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti tË PËRQJES Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
8												
9												
10												
11												
12												
13												
14												
15												
16												
17												
18												
19												
20												
21												
22												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre

(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Vula

VAZHDIM I LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK

MODEL - 03/1

Partia/Koalicioni

QARKU

BASHKIA

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

IV) TË DHËNA KANDIDATI												
Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti tËPËRQËJE Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
23												
24												
25												
26												
27												
28												
29												
30												
31												
32												
33												
34												
35												
36												
37												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre


(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)



Partia/Koalicioni

QARKU

BASHKIA

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

IV) TË DHËNA KANDIDATI												
Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti tË PËRQISHTIMIT Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
38												
39												
40												
41												
42												
43												
44												
45												
46												
47												
48												
49												
50												
51												
52												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre

(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Vula

Partia/Koalicioni

QARKU

BASHKIA

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

IV) TË DHËNA KANDIDATI												
Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti tË PËRQIRJE Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
53												
54												
55												
56												
57												
58												
59												
60												
61												
62												
63												
64												
65												
66												
67												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre

(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Vula

VAZHDIM I LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK

MODEL - 03/1

Partia/Koalicioni

QARKU


BASHKIA

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

IV) TË DHËNA KANDIDATI												
Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti tË PËRQISHTIMIT Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
68												
69												
70												
71												
72												
73												
74												
75												
76												
77												
78												
79												
80												
81												
82												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre



(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Partia/Koalicioni

QARKU

BASHKIA


(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

IV) TË DHËNA KANDIDATI

Nr	Emër	Mbiemër	Atësia	Mëmësia	Gjinia		Datëlindje dd/mm/vvvv	Vendlindja	Subjekti të punës Shkronjat Nistore	Niveli i arsimit		Punësimi Aktual
					M	F				I mesëm	I lartë	
83												
84												
85												
86												
87												
88												
89												
90												
91												
92												
93												
94												
95												
96												
97												
98												
99												

Kjo listë mbyllet me numër rendor

Kryetari i Partisë/Përfaqësuesi i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre



(me shifra)

(me fjalë)

(emër, mbiemër)

,

(nënshkrimi)

,

(data dd/mm/vvvv)

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumenti

“KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT BASHKIAK”

1. Ky dokument plotësohet dhe nënshkruhet nga kryetari i partisë politike/përfaqësues i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre.
2. Në **Seksionin (I)** kërkuesi plotëson të gjitha të dhënat e partisë politike sipas fushave përkatëse.
3. Në **Seksionin (II)** kërkuesi zgjedh Qarkun dhe Bashkinë ku kandidojnë kandidatët për Anëtar të Këshillit Bashkiak.
4. Në **Seksionin (III)** kërkuesi zgjedh ku drejtohet kërkesa në KQZ/KZAZ dhe sipas rastit plotëson nr e KZAZ-së.
5. Në **Seksionin (IV)** kërkuesi plotëson tabelën me të gjitha të dhënat identifikuese të kandidatit sipas zërave përkatës.
6. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
7. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëhere, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse**.
8. Kryetari i partisë politike/Përfaqësues i koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre duhet të nënshkruajnë në fund të këtij dokumenti.
Kësaj liste duhet t'i bashkëlidhet:
 - Deklarata e nënshkruar nga çdo kandidat që gëzon të drejtën dhe ka dëshirë të kandidojë, sipas rastit deklarimin e dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në nenin 63 të Kodit Zgjedhor;
 - Formulari i Vetëdeklarimit pasi të nënshkruhet në çdo faqe nga kandidati duhet të depozitohet pranë KQZ/KZAZ;
 - Vërtetim për zotërimin e mandatit sipas nenit 68, pika 2 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, listën e zgjedhësve që mbështesin partinë/koalicionin;
 - Autorizimi i Kryetarit të Partisë për nënshkrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak (nëse lista shumemërore nuk është nënshkruar nga kryetari i partisë sipas nenit 72, pika 3 e Kodit Zgjedhor);
 - Deklarata e kandidatit për hapjen e llogarisë të posaçme bankare për dhurimin e fondeve jopublike;
9. *Kërkesa për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie gjen mbështetje në nenin 67, dhe nenit 72, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATË PËR PRANIMIN E KANDIDIMIT

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

I) TË DHËNAT E
KANDIDATIT

1. _____ 2. Datëlindja _____
(Emër, Atësia, Mbiemër) dd/mm/vvvv
3. Adresa _____
4. Gjinia M F 5. Vendlindja _____
Bashkia Qarku

II) SUBJEKTI
MBËSHETËS

a) Parti _____ , _____
(emri zyrtar i partisë) (shkronjat nistore)
b) Koalicion _____ , _____
(emri zyrtar i koalicionit) (shkronjat nistore)
c) I propozuar nga zgjedhësit*

III) KANDIDOJ
PËR

Kryetar bashkie Qarku
Anëtar i këshillit bashkiak Bashkia

IV)
DREJTUAR

KQZ
KZAZ nr.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Gëzoj të drejtën dhe pranoj të kandidoj për zgjedhjet e qeverisjes vendore.

* (aplikohet vetëm në rastin e përzgjedhjes së opsionit c, Seksioni II)

Nuk jam pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në zgjedhje, nuk do të mbështes haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në zgjedhje, si dhe nuk jam inancues i asnjë partie politike/koalicioni.

Kam hequr dorë nga funksioni _____

Kandidati

(emër, atësi, mbiemër i kandidatit)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

“DEKLARATË PËR PRANIMIN E KANDIDIMIT”

1. Ky dokument plotësohet dhe nënshkruhet nga kandidati i propozuar nga partia politike/ koalicioni/ kandidati i propozuar nga zgjedhësit.
2. Në **Seksionin (I)** kandidati plotëson të dhënat identifikuese të tij sipas fushave përkatëse.
3. Në **Seksionin (II)** kandidati shënon me kryq kuadratin përbri subjektit mbështetës e më pas plotëson të dhënat e subjektit të përzgjedhur.
4. Në **Seksionin (III)** dhe **Seksionin (IV)** kandidati shënon me kryq llojin e kandidimit, plotëson Bashkinë, Qarkun ku ai kandidon, si dhe kujt i drejtohet kërkesa e kandidimit KQZ/KZAZ-së dhe sipas rastit plotëson numrin e KZAZ-së.
5. Kandidati në çdo rast nëse ushtron një funksion publik i cili është në kundërshtim me nenin 63, pika 4 i Kodit Zgjedhor, plotëson funksionin nga i cili heq dorë.
6. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
7. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëhere, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse**.
8. Kandidati duhet të nënshkruajë në fund të këtij dokumenti.
9. Kësaj deklarate, sipas rastit, i bashkelidhet kopja e deklaratës së dorëheqjes së kandidatit nga funksionet e përcaktuara në nenin 63, pika 4 të Kodit Zgjedhor, depozituar pranë institucionit përkatës.
10. *Deklarata per pranimin e kadidimit gjen në nenet 69 pika 2, 70 pika 2, 72 pika 2, shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

I) KËRKUESIT

1. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

2. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

3. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

4. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

5. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

6. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

7. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

8. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

9. _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

II) KANDIDATI
QË
MBËSHKETETET

Kandidati _____
(Emër, Atësia, Mbiemër)

Kryetar bashkie Qarku
Anëtar i këshillit bashkiak Bashkia

III) DREJTUAR

KQZ
KZAZ nr.

Anëtarët e Komitetit Nismëtar	Firma
1. _____	_____
2. _____	_____
3. _____	_____
4. _____	_____
5. _____	_____
6. _____	_____
7. _____	_____
8. _____	_____
9. _____	_____

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

“KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KOMITETIT NISMËTAR”

1. Ky dokument plotësohet dhe nënshkruhet nga anëtarët e Komitetit Nismëtar.
2. Në **Seksionin (I)** anëtarët plotësojnë të dhënat identifikuese të tyre sipas fushave përkatëse.
3. Në **Seksionin (II)** dhe **Seksionin (III)** anëtarët plotësojnë të dhënat identifikuese të kandidatit që mbështësin, funksionin për të cilin kandidon, Bashkinë, Qarkun ku ai kandidon, si dhe kujt i drejtohet kërkesa e kandidimit KQZ/KZAZ-së dhe sipas rastit plotëson numrin e KZAZ-së.
4. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
5. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëhere, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse**.
6. Anëtarët e Komitetit Nismëtar duhet të nënshkruajnë në fund të këtij dokumenti.
7. Kësaj liste duhet t'i bashkëlidhet kopje e vlefshme e dokumentit të identifikimit për secilin nga anëtarët e Komitetit Nismëtar.
8. *Kërkesa për regjistrimin e Komitetit Nismëtar gjen mbështetje në nenin 70, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*





MODEL-06

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT TË PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

KËRKUESI

KOMITETI NISMËTAR

I) KANDIDAT
PËR

Kryetar bashkie

Qarku

Anëtar i këshillit bashkiak

Bashkia

II)
DREJTUAR

KQZ

KZAZ nr.

III) TË DHËNAT E
KANDIDATIT1. _____
(Emër) (Mbiemër) (Atësia) (Mëmësia)2. Datëlindja _____ 3. Adresa _____
dd/mm/vvvv4. Gjinia M F 5. Vendlindja _____
Bashkia Qarku

5. Arsimi i mesëm i lartë 6. Punësimi Aktual _____

Anëtarët e Komitetit Nismëtar

Firma

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

7. _____

8. _____

9. _____

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

“KËRKESË PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT TË PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT”

1. Ky dokument plotësohet dhe nënshkruhet nga anëtarët e Komitetit Nismëtar.
2. Në **Seksionin (I) dhe (II)** anëtarët plotësojnë llojin e kandidimit të kandidatit që mbështesin, Bashkinë, Qarkun ku ai kandidon, si dhe kujt i drejtohet kërkesa e kandidimit KQZ/KZAZ dhe sipas rastit plotësojnë numrin e KZAZ-së.
3. Në **Seksionin (III)** anëtarët plotësojnë të dhënat identifikuese të kandidatit sipas përcaktimeve në fushat përkatëse.
4. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
5. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëherë, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse**.
6. Anëtarët e Komitetit Nismëtar duhet të nënshkruajnë në fund të këtij dokumenti.
7. Dokumentit duhet t'i bashkëlidhen:
 - Tabela me nënshkrimet e zgjedhësve, emrat e të cilëve janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, të zonës zgjedhore të përcaktuar në këtë dokument;
 - Vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zoterimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit në referim të nenit 70/4 të “Kodit Zgjedhor”
 - Kopje të dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga zgjedhësi i përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore përkatëse;
 - deklaratën e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër.
8. *Kërkesa për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit gjen mbështetje në nenin 70, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

MODEL - 09

FORMULAR PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE TË ZGJEDHËSVE PËR MBËSHTETJE KANDIDATI

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

I) TË DHËNAT
E SUBJEKTIT

PARTI POLITIKE

KOALICION

KOMITET NISMËTAR

(emri zyrtar i partisë/koalicionit)

(shkronjat nistore)

II) ZONA E
KANDIDIMIT

QARKU

BASHKIA

III) LLOJI I
KANDIDIMIT

KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE

(emër, atësi, mbiemër)

(datëlindja dd/mm/vvvv)

LISTË SHUMEMËRORE PËR ANËTARË KËSHILLI

KANDIDAT PËR ANËTAR I KËSHILLIT BASHKIAK I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT

Unë zgjedhësi i poshtëshënuar deklaroj se jap pëlqimin për kandidatin/kandidatët sa më sipër. Unë jam zgjedhës në zonën zgjedhore të mësipërme dhe kam mbushur moshën/ ose do të jem 18 vjeç ditën e zgjedhjeve

TABELA E NËNSHKRIMEVE

Nr	Emër	Mbiemër	Datëlindje dd/mm/vvvv	Adresa	Nënshkrimi	Nr. Kontakti

Përfaqësuesi i partisë/koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre/Përfaqësuesi i Komitetit Nismëtar

(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

(data dd/mm/vvvv)

VAZHDIM I TABELËS

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Data e zgjedhjeve

QARKU

BASHKIA

Kandidati

Parti /Koalicioni

Komitet Nismëtar

Nr	Emër	Mbiemër	Datëlindje dd/mm/vvvv	Adresa	Nënshkrimi	Nr. Kontakti

Përfaqësuesi partisë/k koalicionit ose personi i autorizuar prej tyre/Përfaqësuesi i Komitetit Nismëtar

(emër, mbiemër)

,

(nënshkrimi)

,

(data dd/mm/vvvv)

Sqarim:

Mbi mënyrën e plotësimit të dokumentit

“FORMULAR PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE TË ZGJEDHËSVE PËR MBËSHTETJE KANDIDATI”

1. Ky dokument plotësohet sipas rastit nga partitë politike të cilat nuk zotërojnë mandate në organet e qeverisjes vendore ose koalicioni që zotëron një numër mandatesh më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. Ky dokument plotësohet nga komiteti nismëtar i cili është i ngarkuar për mbledhjen e nënshkrimeve të mbështetësve (zgjedhësve) për kandidatin.
2. Në **Seksionin (I)** dhe **(II)** kërkuesi shënon me kryq kuadratin përbri subjektit mbështetës e më pas plotëson të gjitha të dhënat e subjektit të përzgjedhur, plotëson Qarkun dhe Bashkinë ku kandidon kandidati.
3. Në **Seksionin (III)** kërkuesi shënon me kryq kuadratin përbri funksionit për të cilin kandidon kandidati. Nëse kandidati është i propozuar nga parti politike/koalicion, atëherë kërkuesi përzgjedh funksionin e kandidatit për kryetar bashkie ose për anëtar këshilli bashkiak i listës shumememore. Nëse subjekti mbështetës është komitet nismëtar, atëherë kërkuesi përzgjedh funksionin e kandidatit për kryetar bashkie ose për anëtar të këshillit bashkiak të propozuar nga zgjedhësit.
4. Secili nga mbështetësit (zgjedhësit) plotëson të dhënat identifikuese sipas tabelës, si dhe depoziton personalisht nënshkrimin në kuadratin përkatës të formularit. Këtij formulari i bashkëlidhet dhe fotokopje e nënshkruar e dokumentit identifikues të vlefshëm.
5. Ky dokument këshillohet të plotësohet në formatin elektronik, i cili gjendet në faqen e internetit të KQZ-së www.kqz.gov.al dhe më pas të printohet e të nënshkruhet.
6. Nëse do të plotësohet në versionin e paraprintuar, atëherë, të gjitha të dhënat që përmban modeli duhet të plotësohen pa korrigjime dhe me **SHKRONJA KAPITALE vetëm në fushat përkatëse**.
7. Përfaqësuesi i partisë politike/koalicionit ose personi i autorizuar prej tij/përfaqësuesi i komitetit nismëtar duhet të nënshkruajnë në fund të këtij dokumenti.
8. *Plotësimi i Formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati gjen mbështetje në nenin 71 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*

